



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/04

Datë: 01.03.2022

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 53, Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.9.2010), neni 36 dhe 38, Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 28.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komitetit për Komunitete

- I. Me këtë vendim Kuvendi themelon Komitetin për Komunitete si komitet i përhershëm në Komunën e Junikut dhe përcakton strukturën e tij.
- II. Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) NR. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë neni 9, paragrafi 2, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete zgjidhet me shumicën e votave të anëtareve të Komitetit.
- III. Komiteti për Komunitete do të ketë përbërjen si në vijim:
 1. Zejnepe Gaxherri – anëtarë - subjekti politik LDK,
 2. Zenel Maloku – anëtarë - subjekti politik AAK,
 3. Eliza Pepshi – anëtare - subjekti politik LVV,
 4. Valdrin Isufaj – anëtarë - Komiteti i Biznesit,
 5. Safete Shehu – anëtare - OJQ.
- IV. Komiteti për komunitete është përgjegjës për promovimin dhe afirmimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe shqyrton çdo shkelje që bëhet në këtë drejtim, duke rekomanduar në Kuvendin e Komunës, shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për tu siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht, për të shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe sigurimin dhe mbrojtjen adekuate të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhen zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Anëtarët e Komitetit për Komunitete,
- Drejtori për Ekonomi Buxhet dhe Financa,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Shpejtim Gacaferi

